

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Gani Zabeli, kryetar kolegji, Shqipe Qerimi e Hashim Çollaku, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional, Vjollca Kurtishaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.R. nga fshati ..., për shkak të veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme, parashikuar me nenin 332 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti , P.nr.609/2016 datë 18.05.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur 09.10.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti, P.nr.609/2016 datë 18.05.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan-Dega në Viti P.nr.609/2016 datë 18.05.2018, të akuzuarin S.R., bazuar në nenin 364 par.1.nënpar.1.3 të KPPK e ka liruar nga akuza se ka kryer veprën penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme, parashikuar me nenin 332 par.1 të KPRK, meqë nuk është provuar se ka kryer veprën penale për të cilën ishte akuzuar. Kërkesë pasurore-juridike nuk ka pasur. Shpenzimet e procedurës i janë vënë në barrë mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me propozim që kjo Gjykatë ta prish aktgjykimin e atakuar dhe të njëjtin ta kthen në rigjykim dhe rivendosje, në mënyrë që gjendja faktike të vërtetohet në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Prokurori i Apelit me shkresën PPA/II.nr.881/18 datë 17.09.2018 ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorit, aktgjykimi i kundërshtuar të anulohet dhe lëndën ta kthen në rigjykim dhe rivendosje

Gjykata e Apelit pasi i shqyrtoi shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitë e nenit 394 të KPP, dhe pasi që i vlerësoi pretendimet në ankesë gjeti se:

-ankesa nuk është e bazuar.

Në ankesën e Prokurorit, pretendohet se gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar drejt faktin se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe të njëjtin e ka liruar nga akuza me arsyetim se nuk ka prova që provojnë se i njëjti e ka kryer veprën penale të lart cekur. Sipas ankesës, kryerja e veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme, parashikuar me nenin 332 par.1 të KPRK, nga ana e të akuzuarit është vërtetuar me provat materiale që gjinden në shkresa të lëndës dhe bazuar në deklaratën e dëshmitarit N.K. sipas të cilit i dëmtuari S.R kishte shkuar në stacionin policor ku kishte paraqitur rastin vullnetarisht dhe pa kurrfarë presioni, me dokumente, ku kishte kërkuar ndihmë sepse tani i akuzuari S.R. e kishte mbjellë pronën e tani të dëmtuarit por gjykata ia ka falur besimin tani të dëmtuarit dhënë në shqyrtimin gjyqësor.

Të pabazuara janë pretendimet ankimore të Prokurorit, se aktgjykimi i ankimuar është mbështetur në gjendjen faktike të vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë e si pasojë e vlerësimit të gabuar të provave. Sipas qëndrimit të kësaj gjykate gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, sepse nga deklarata e të dëmtuarit S.R. dhe të akuzuarit S.R., gjykata ka vërtetuar se këta dy janë vëllezër dhe që secili është pronar i paluajtshmërsë në siparfaqe prej 32 ari. Sipas deklaratës së tani të akuzuarit, i njëjti ka mohuar se vëllait të tij ia ka uzurpuar arën sepse ai nuk i punon as arët e veta. Njëherit ka njoftuar gjykatën se prona e tani të dëmtuarit kufizohet me pronën e axhës së tyre, i cili don me ia marrë vëllait të tij arën në sipërfaqe prej 10 ari, e cila gjindet në pjesën perëndimore të pronës së vëllait të tij. I dëmtuari S.R. në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se vëllai i tij, tani i akuzuari S. nuk është fajtor aspak dhe se ai vetë kishte gabuar kur për këtë vepër penale e kishte paraqitur në polici tani të akuzuarin, se gabimi nuk ka qenë i qëllimtë, se çështjen pronësore me axhën e vet, të cilin gjithashtu e ka paraqitur në polici, e ka rregulluar përmes gjykatës dhe më nuk ka probleme as me te, se axha i tij M. kishte korrë në arën e vet dhe jo në arën e tij dhe se paraqitja e të njëjtëve në polici ka qenë pasojë e moshës së tij sepse është i moshës 84 vjeçare. Vlen të theksohet se i dëmtuari nuk i është bashkëngjitur ndjekjes penale ndaj të akuzuarit dhe nuk ka parashtruar kërkesë pasurore-juridike.

Kolegji penal i kësaj Gjykate vlerëson se në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike lidhur me veprën uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme, parashikuar me nenin 332 par.1 të KPRK, dhe drejtë ka vepruar kur të akuzuarin e ka liruar nga akuza konform nenit 364 par.1.nënpar.1.3 të KPPK, për shkak se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale, i cili konkludim i shkallës së parë është i pranueshëm edhe për këtë gjykatë.

Duke pasur parasysh rrethanat e lart cekura si dhe duke vlerësuar faktin se përgjegjësia penale duhet të provohet, Kolegji penal i kësaj Gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka pasur vend që të aplikojë institutin juridik "in dubio pro reo", e pranoi mbrojtjen e të akuzuarit se ai nuk është vënë në dilemë me asnjë provë nga përfaqësuesi i akuzës dhe e liroi nga akuza.

Nga sa u tha më lartë e sipas dispozitës së nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr 875/18 me datë 09.10.2018

Bashkëpunëtori profesional
Vjollca Kurtishaj

Kryetari i kolegjit-gjyqtari,
1 .Gani Zabeli

Anëtarët e kolegjit:

2.Shqipe Qerimi
3.Hashim Çollaku